

20222363436

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J I

PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT TË REZERVAVE TË DETYRUESHME TË NAFTËS

Neni 1

Në Ligjin e Rezervave të Detyrueshme të Naftës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 144/14, 178/14, 199/15, 197/19 dhe 07/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 275/19 dhe 150/21), pas nenit 36-z, shtohet titulli i ri dhe neni i ri 36-x, si në vijim:

“Kushtet dhe mënyra e dhënies së huave afatshkurtra dhe/ose lëshimit të rezervave të detyrueshme të naftës gjatë ekzistimit të gjendjes së krizës në furnizimin me energji termike dhe elektrike

Neni 36-x

(1) Rezervat e detyrueshme të derivateve të naftës mund të shfrytëzohen gjatë gjendjes së shpallur të krizës në furnizimin me energji termike në zonën e Qytetit të Shkupit dhe në furnizimin me energji elektrike në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kur ekziston nevojë urgjente për derivatet e naftës nga ndërmarrjet publike dhe personat tjerë juridikë dhe institucionet e themeluara nga shteti që kryejnë veprimtari përkatëse energjetike të përcaktuara me ligj.

(2) Shfrytëzimi i rezervave të detyrueshme të naftës gjatë gjendjes së krizës energjetike, kryhet me dhënie huaje afatshkurtra të llojeve të caktuara të derivateve të naftës ndërmarrjeve publike dhe personave tjerë juridikë dhe institucioneve të themeluara nga shteti që kryejnë aktivitetet e tyre të përcaktuara me ligj.

(3) Shfrytëzimi i rezervave të detyrueshme mund të kryhet edhe me lëshim pa kompensim të llojeve të veçuara të derivateve të naftës nga rezervat e detyrueshme të ndërmarrjeve publike dhe personave tjerë juridikë dhe institucioneve të themeluara nga shteti që kryejnë aktivitetet përktëse energjetike të përcaktuara me ligj.

(4) Derivatet e lëshuara të naftës së paragrafit (3) të këtij neni mund të jenë në sasi që, gjatë vitit kalendarik nuk do të tejkalojnë 50% të sasisë së përgjithshme të magazinuar të rezervave të detyrueshme për çdo derivat të naftës veçmas.

(5) Për shfrytëzuesit, shpenzimet e dërgesës, llojin, sasi të dhe destinimin e derivateve të naftës, që huazohen dhe/ose lëshohen pa kompensim, si dhe për afatin e kthimit të sasive të huazuara në rastet nga paragrafët (2) dhe (4) të këtij neni, vendos Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.”.

Neni 2

Dispozitat e nenit 1 të këtij ligji do të zbatohen deri në ditën e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.